



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Rruga "Abdi Toptani" ish- hotel "Drini", Tiranë

Tel. 04 268142; Fax 04268141

Nr. 943/3 Prot.

Tiranë, më 12.06.2017

V E N D I M
Nr. 130, datë 12.06.2017

"Mbi përfundimin e verifikimit të informacionit të marrë nëpërmjet postës elektronike, dërguar në adresën zyrtare të Komisionerit, në datën 05.06.2017",

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1 dhe nenet 14 e 15, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar; të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i RSH", si dhe Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Mbikëqyrjes dhe Inspektimit, në përfundim të procedurës së verifikimit,

VËREJ SE :

Me anë të një letre, dërguar në datën 05.06.2017, në adresën postare elektronike të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, një qytetar (*i cili kërkon të mbetet anonim*) ka denoncuar pjesëmarrjen e nëpunësit ***** në kundërshtim me ligjin, në veprimtari politike. Këtë pretendim, denoncuesi e ka shoqëruar edhe me disa fotografi, ku shfaqet nëpunësi i denoncuar në një takim elektorale të Partisë Socialiste Kukës. Nisur nga ky informacion, me aktin nr. 943 prot., datë 06.06.2017, Komisioneri urdhëroi fillimin e verifikimit të këtij rasti.

Me qëllim që të zhvillohej një hetim administrativ i plotë dhe objektiv, fillimisht u dërgua grupi i inspektimit në subjekt, pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Kukës, ku është i punësuar punonjësi në fjalë, ku u këqyr dhe u administrua dokumentacioni i nevojshëm, nga analiza e të cilit rezultoi se , nëpunësi ***** me aktin nr. 4604, datë 28.07.2016, të Departamentit të Administratës Publike, është emëruar në pozicionin e punës "Drejtor", në Drejtorinë Rajonale Tatimore Kukës, sipas procedurave të konkurrimit për ngritje në detyrë, të përcaktuara në ligjin nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar.

Në bazë të këtij akti, Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, me urdhrin nr. 541, datë 03.08.2016, ka urdhëruar fillimin e marrëdhënieve financiare për nëpunësin në fjalë.

Gjatë vizitës së realizuar në subjekt, nga ana e grupit të inspektimit të autorizuar nga Komisioneri për të verifikuar këtë rast, fillimisht është pyetur nëpunësi ***** në lidhje me rrethanat e ngjarjes, i cili pohoi se ka qenë i pranishëm në takimin e elektorat të zhvilluar nga Partia Socialiste Kukës. Nga ana e këtij punonjësi u sqarua se, ky takim është realizuar rreth 3 javë më parë, pikërisht në datën 16.05.2017, rreth orës 19, pra, pas orarit zyrtar të punës. Nëpunësi deklaroi gjithashtu, se takimi elektorat u realizua në fshatin Canaj, pjesë e Njësinë Administrative Bicaj, ku ai ka vendbanimin dhe se, gjatë gjithë kohës në atë takim elektorat, ai ka dëgjuar kandidatin për deputet të asaj zone dhe stafin e tij elektorat, pa shprehur asnjë preferencë politike.

Nëpunësi, deklaroi se sjellja e tij si funksionar publik në këtë rast, është në përputhje me ligjin, pasi ai ka të drejtë të marrë pjesë në veprimtari politike jashtë orarit zyrtar. Ky deklaram i punonjësit, u materializua edhe me procesverbalin administrativ të datës 07.06.2017, i cili administrohet në dokumentacionin e grumbulluar për verifikimin e çështjes.

Për të verifikuar situatën në të cilën ka vepruar nëpunësi dhe për të sqaruar rrethanat e ngjarjes, u pyetën disa dëshmitarë, thëniet e të cilëve janë materializuar në procesverbalet administrative të datës 07.06.2017. Këta shtetas shfaqen prezent në fotografitë e dërguara nga denoncuesi.

Konkretisht u pyet shtetasi ***** (*paraqitet ulur, në krah të djathtë të nëpunësit*), shtetasi ***** (*paraqitet ulur në të njëjtën tavolinë me nëpunësin*), shtetasi ***** (*ndodhet ulur në të njëjtën tavolinë me nëpunësin*) dhe shtetasi ***** (*shfaqet i ulur, përballë nëpunësit*).

Nga deklaratat e administruara prej dëshmitarëve të përmendur më sipër, rezultoi i vërtetë fakti se, është zhvilluar një veprimtari politike nga Partia Socialiste e Qarkut Kukës, në fshatin Canaj, pjesë e Njësisë Administrative, Bicaj, për të prezantuar kandidatin për deputet dhe programin qeverisës.

Kjo veprimtari, sipas të gjithë dëshmive të marra, të cilat janë të administruara në dosjen përkatëse, është realizuar në datën 16.05.2017, rreth orës 19.

Po kështu, të pyetur nëse nëpunësi ***** , ka manifestuar në ndonjë moment bindjet e tij politike, duke ndërmarrë veprime të tilla si, protagonist në foltore gjatë aktivitetit elektorat, apo të ketë manifestuar me pankarta në duar, ose të ketë kryer sjellje të tjera që tregojnë dukshëm bindjen e tij politike, dëshmitarët kanë deklaruar se nëpunësi në fjalë, gjatë gjithë kohës, vetëm ka dëgjuar stafin elektorat dhe në asnjë moment nuk ka kryer veprimet e përshkruara më sipër.

Fakti se nëpunësi ***** , nuk ka treguar protagonizëm gjatë këtij aktiviteti, mbështetet edhe nga analiza e fotografive të dërguara nga denoncuesi, në të cilat duket qartë se, në asnjërin prej tyre, ky nëpunës nuk është duke folur.

Në vijim të këtij hetimi, për të vërtetuar subjektin që i ka publikuar këto foto, u këqyr dhe faqja në adresën elektronike në “facebook”, e Partisë Socialiste, Qarku Kukës, nga e cila rezultoi se kjo organizatë politike, ka zhvilluar një veprimtari, të emërtuar “*Takimi me anëtarët e Organizatës Socialiste, Bicaj*” (*shiko këtë rubrikë “ctrl + klik*”), në Njësinë Administrative Bicaj. Nga verifikimi i fotove të shkrepura nga stafi elektorat dhe të shkarkuara në “facebook”, në datën 17.05.2017, konstatohet se janë të njëjtat foto, të cilat janë dërguar në adresë të

Komisionerit nga denoncuesi. Nisur nga ky konstatim, arrijmë në konkluzionin se, nga njëra anë këto foto nuk janë publikuar nga punonjësi në fjalë, në mbështetje të një force politike, dhe nga ana tjetër, që denoncuesi nuk i ka fiksuar vetë fotot, por i ka marrë ato pikërisht nga faqja në “facebook”, e Partisë Socialiste, Kukës.

Për të hetuar në lidhje me prezencën në punë të punonjësit ******, u administrua pranë njësisë së burimeve njerëzore të ngarkuar për të kryer veprimet në lidhje me personelin në këtë degë tatimore, listë prezencë e datës 16.05.2017 (protokolluar nr. 17/1), nga analiza e të cilës, rezulton se nëpunësi ******, ka qenë prezent në punë në ditën në fjalë, nga ora 8.00, deri në orën 16.30 dhe nuk administrohet asnjë provë tjetër që të vërtetojë të kundërtën.

Për të gjitha sa analizuam më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se, nëpunësi ******, ka marrë pjesë në një veprimtari politike, të zhvilluar nga një subjekt politik, jashtë orarit zyrtar të punës dhe gjatë kësaj veprimtarie nuk ka manifestuar në asnjë moment bindjet e tij politike, ç’ka do të thotë se nga ana e tij nuk është kryer asnjë veprim në kundërshtim me ligjin.

E drejta e nëpunësit civil, për të marrë pjesë në veprimtari politike, jashtë orarit zyrtar, është e sanksionuar në pikën 1, të nenit 37, “*Të drejtat politike*”, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, ku në mënyrë të shprehur përcaktohet se:

“1. Nëpunësi civil ka të drejtë të marrë pjesë në veprimtari politike jashtë orarit zyrtar. Nëpunësi civil nuk duhet të shprehë publikisht bindjet apo preferencat e tij politike.

Nga përmbajtja e kësaj dispozite, rezulton se nëpunësi civil ka të drejtë të marrë pjesë në veprimtari politike, por e kufizon këtë të drejtë, me klauzolën “*jashtë orarit zyrtar*”.

Më tej, kjo dispozitë vijon me përcaktimin se nëpunësi civil nuk duhet të shprehë publikisht bindjet apo preferencat e tij politike, i lidhur ky ndalim me pjesën e parë të saj, pra jashtë orarit zyrtar, në kushtet kur gjatë orarit zyrtar nëpunësi e ka të ndaluar të marrë pjesë në veprimtari politike.

Në këto rrethana, qëllimi i kësaj pike të dispozitës, është të disiplinojë nëpunësit civilë që të ushtrojnë vetëkontroll për sa i përket manifestimit në publik të pikëpamjeve politike dhe besnikërisë në një forcë politike në jetën private, ç’ka do të thotë që, ata nuk mund të manifestojnë me pankarta në duar, apo të jenë protagonistë në foltoret e subjekteve politike që zhvillojnë fushatën zgjedhore.

Por, nga ana tjetër, ekzistenca e kësaj dispozite nuk duhet të çojë në një interpretim të zgjeruar të saj, duke i ndaluar kategorikisht nëpunësit civilë të marrin pjesë në veprimtari politike, apo në organizime zgjedhore të subjekteve politike jashtë orarit zyrtar, pasi kjo e drejtë e tyre, buron nga e drejta që ata kanë për të zgjedhur alternativën qeverisëse, ç’ka arrihet duke dëgjuar subjektet zgjedhore dhe programet që ata paraqesin.

Në përfundim, Komisioneri arrin në konkluzionin se, në rastin e trajtuar në këtë vendim, nuk ndodhemi në kushtet e veprimeve që vijnë në kundërshtim me rregullimet e posaçme të ligjit për nëpunësin civil, të cilat kanë të bëjnë me sjelljen e nëpunësit civil, në situatën e zgjedhjeve politike.

Për këto arsye:

Bazuar në nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, në ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” e nenin 34, të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Të përfundoj verifikimin e informacionit të marrë në datën 05.06.2017, nëpërmjet adresës postare elektronike të Komisionerit, me konkluzionin se, punonjësi *****, nuk ndodhet në kushtet e veprimeve që vijnë në kundërshtim me rregullimet e posaçme ligjore, në lidhje me sjelljen e nëpunësit civil, në rastin e zgjedhjeve politike,
2. Të njoftohen për këtë vendim, Departamenti i Administratës Publike, Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, si dhe nëpunësi *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA